VENDIM
Nr.513, datë 13.5.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "UNAZA, KAVAJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 " Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza, Kavajë".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 498 (katërqind e nëntëdhjetë e tetë) m², tokë/truall, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 10 436 170 (dhjetë milionë e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë.

4. Ky fond prej 10 436 170 (dhjetë milionë e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 256 000 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

6. Shpronësimi të fillojë më 30.5.2009 dhe të përfundojë më 30.8.2009.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Proces regjistrimi" dhe "Konfirmim ZRPP", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë verifikimet për përputhshmërinë e sipërfaqeve, që shpronësohen, me numrat e pasurive në pronësi të pronarëve.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS "UNAZA KAVAJË"

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadas.		Sipërf.	Lloji i pasurisë					Shuma	Shënime
					Nr.	Përgj.	Truall			Objekt			
					pasurisë	m^2	m^2	Çmimi	Vl.(lekë)	(Lloji)	Vl.(lekë)		
1	Idajet	Halim	Gjylsheni	8552	10/199	131.3	43	17982	773226			773226	Konf.zvrpp
2	Vath	Halim	Gjylsheni	8552	10/200	570	43	17982	773226			773226	Konf.zvrpp
3	Fadil	Hysen	Lushkja	8552	9/107	725	23	15763	362549			362549	Konf.zvrpp
4	Azem	Murat	Lushkja	8552	14/156	417	31	15763	488653			488653	Proc.regjis.
5	Trashigir	Ramazan	Arapi	8552	13/174	244	36	15763	567468			567468	Proc.regjis.
6	Besnik	Haxhi	Qerosi	8552	13/93	200	82	15763	1292566			1292566	Proc.regjis.
7	Muharrem	Hamdi	Cela	8552	17/104	256.3	22	15763	346786	banesë	2273317	2620103	Proc.regjis.
8	Maksim	Qamil	Beja	8552	9/175	181.5	35	17982	629370			629370	Proc.regjis.
9	Mehmet	Rrahman	Jakupi	8552	13/102	878	8	15763	126104			126104	Proc.regjis.
10	Arben		Gjini	8552	10/203	716	8	17982	143856			143856	Proc.regjis.
11	Rasim		Bali	8552	17/50	460	63	15763	993069			993069	Proc.regjis.
12	Ali	Avdyl	Jaupi	8552	15/102	170	23	15763	362549			362549	Proc.regjis.
13	Skënder	Qerim	Kazazi	8552	13/14	210	7	15763	110341			110341	Proc.regjis.
14	Hajdar		Rrena	8552	3/158	285	62	15763	977306			977306	Konf.zvrpp
15	Bashkëpronarët Gjylsheni			8552	10/205	262.2	12	17982	215784			215784	Konf.zvrpp
	Shuma:						498		8162853		2273317	10436170	